



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri
Mbledhja nr.59/2016
Prishtinë, më 7.6.2016, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK,
INFRASTRUKTURË, TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Muhamet Mustafa, kryetar, Sasha Milosavleviç, Besim Beqaj, Raif Qela, Sala Berisha-Shala, Fatmir Rexhepi, Blerim Grainca dhe Duda Balje, anëtarë, si dhe Shaip Muja, pa grup parlamentar.

Munguan: Visar Ymeri, Pal Lekaj dhe Enver Hoti, anëtarë.

Pjesëmarrës të tjerë: Lumnije Murati, ZPRK; Fjolla Uka, KDI; Dardan Abazi, INDEP dhe Leutrim Latifi, praktikant.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Muhamet Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 31.5.2016;
3. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime për Projektligjin nr.05/L-081 për Energjinë;
4. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime për Projektligjin nr.05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë;
5. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime për Projektligjin nr.05/L-085 për Energjinë elektrike;
6. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime për Projektligjin nr.05/L-082 për Gazin natyror;
7. Ecuria në realizimin e planit vjetor të punës së Komisionit;
8. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Shaip Muja, deputet i pavarur, tha se arsyeja pse është prezent në këtë mbledhje të Komisionit, është për të kërkuar që t'i paraqesë dy çështje: çështja e parë është lidhur me kompaninë "Ferronikeli", e cila është privatizuar nga ish- Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM). Problemet në këtë kompani janë si rezultat i obligimeve të marra me kontratë me KEK-un, për blerjen e energjisë elektrike. Tani, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), si trashëgimtare e AKM-së, duhet t'iu hapë rrugë problemeve që kanë dalë nga privatizimi i ish-ndërmarrjes "Ferronikeli", lidhur me kërkesën e 900 punëtorëve të kësaj kompanie, pasi rrezikojnë të humbin vendet e punës, për shkak të mundësisë së falimentimit të kompanisë "Ferronikeli". Ju si Komision Funkcional, Kuvendi dhe AKP-ja, duhet të asistojnë në mbështetje të punëtorëve, në aspektin ligjor. Ndërsa, çështja dytë është për Projektligjin për Komunën e Obiliqit, që ndërlidhet me Ligjin për miniera dhe minerale, që është në fushëveprimin e Komisionit për Zhvillim Ekonomik. Në këtë projektligj, është propozuar që 20%-shi i tantimës t'i takojë Komunës së Obiliqit dhe të Drenasit, pasi që kjo lëndë e parë merret nga këto dy komuna dhe këto të hyra duhet t'iu takojnë këtyre dy komunave, duke iu shkuar në buxhetin komunal ose të shkojnë drejtpërdrejt në buxhetin e Kosovës, pastaj këto mjete financiare, prej të hyrave të 20%-shit, t'i ndahen Komunës së Obiliqit dhe të Drenasit. Po ashtu, tha se ky projektligj duhet të shikohet se a është në kolizion me Ligjin për miniera dhe minerale.

Raif Qela, propozoi që çështja e Ferronikelit të diskutohet si pikë e rendit të ditës apo në të ndryshme.

Muhamet Mustafa, kryetar, tha se i kupton shumë drejt kërkesat e punëtorëve të kompanisë "Ferronikeli". Për këtë çështje, së bashku me deputetin Raif Qela, kemi biseduar me drejtorin dhe menaxhmetin e kompanisë. Ndërsa, është AKP-ja që e ka pasur nën mbikëqyrje gjatë fazës së monitorimit. Si Komision, mund të diskutojmë me AKP-në dhe KEDS-in, se çka kanë mundësi për t'iu ndihmuar në aspektin ligjor.

Besim Beqaj, lidhur për kompaninë "Ferronikeli" për çështjen energjisë, zgjidhja më mirë do të ishte liberalizimi i tregut të energjisë, i cili do të ndodhë me miratimin e ligjeve të energjisë dhe kjo është forma më e mirë që të blejnë energjinë vetë, pra ku e gjejnë më lirë. Ne nuk mund të hyjmë në çështje të brendshme komerciale të ndërmarrjes. Ndërsa, për Ligjin për Obiliqin, lidhur me tantimën, arsyeja është se duhet të ndryshohet Ligji për menaxhimin financave publike, sepse pa ndryshuar Ligji mbi menaxhimin e financave publike, nuk mund të zbatohet Ligji për Obiliqin.

Kryetari, në fund, tha se për çështjet që u paraqitën, për aq sa kemi kompetencë në fushëveprimin e Komisionit, do ta shqyrtojmë dhe analizojmë se çka kemi mundësi të bëjmë dhe kjo çështje do të diskutohet në pikën të ndryshme.

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 31.5.2016

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 31.5.2016, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime për Projektligjin nr.05/L-081 për Energjinë

Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit, tha se sa i përket pakos së projektligjeve të energjisë, i kemi diskutuar gjerë e gjatë të gjitha amendamentet dhe i kemi harmonizuar me komentet e propozuara nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë. Po ashtu, raporti me amendamente ka qenë nëpër të gjitha komisionet e përhershme, kështu që nuk kanë dhënë ndonjë propozim apo vërejtje dhe duhet t'i procedojmë për në seancë plenare, në lexim të dytë.

Komisioni, njëzëri, nxori këtë:

Përfundim

- 1. Miratohet Raporti me rekomandime për Projektligjin nr. 05/L-081 për Energjinë;*
- 2. Raporti me rekomandime t'i procedohet Kuvendit për lexim të dytë.*

4. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime për Projektligjin nr.05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë

Kryetari theksoi se e njëjta procedurë është zhvilluar edhe me këtë projektligj dhe i ftoi deputetët të votojnë për miratim.

Komisioni, njëzëri, nxori këtë:

Përfundim

- 1. Miratohet Raporti me rekomandime për Projektligjin nr.05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë;*
- 2. Raporti me rekomandime t'i procedohet Kuvendit për lexim të dytë.*

5. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime për Projektligjin nr.05/L-085 për Energjinë elektrike

Kryetari theksoi se e njëjta procedurë është zhvilluar edhe me këtë projektligj dhe i ftoi deputetët të votojnë për miratim.

Komisioni, njëzëri, nxori këtë:

Përfundim

- 1 Miratohet Raporti me rekomandime për Projektligjin nr. 05/L-085 për Energjinë elektrike;*

2. Raporti me rekomandime t'i procedohet Kuvendit për lexim të dytë.

6. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime për Projektligjin nr.05/L-082 për Gazin natyror

Kryetari, po ashtu tha se e njëjta procedurë është zhvilluar edhe me Projektligjin për Gazin natyror, i cili është projektligji i fundit i pakos së energjisë dhe i ftoi deputetët të votojnë për miratim.

Komisioni, njëzëri, nxori këtë:

Përfundim

1 Miratohet Raporti me rekomandime për Projektligjin nr. 05/L-082 për Gazin natyror;

2. Raporti me rekomandime t'i procedohet Kuvendit për lexim të dytë.

7. Ecuria në realizimin e Planit vjetor të punës së Komisionit

Kryetari theksoi se sa i përket realizimit të planit vjetor të punës së Komisionit, këta 5 muaj kemi pasur një punë intensive, ku për çdo muaj i kemi shqyrtuar, mesatarisht, nga dy projektligje. Ai theksoi se pothuajse në tërësi është realizuar plani i punës me shqyrtimin e projektligjeve dhe të raporteve të agjencive, ku janë shqyrtuar katër raporte, pra ato që deri tani janë proceduar për në Komision. Ndërsa, ato që na kanë mbetur pa u realizuar deri më tani, janë vizita nëpër biznese dhe nëpër agjencitë e pavarura, që janë në fushën e Komisionit. Po ashtu, z. Mustafa tha se lidhur me realizimin e planit vjetor të punës së Komisionit, për muajt në vijim, pos projektligjeve dhe raporteve që mund të procedohen, na kanë mbetur pa u realizuar edhe mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve dhe pa u nxjerrë rekomandimet për Agjencinë e Statistikave, si dhe mbikëqyrja e zbatimit të rekomandimeve që janë miratuar.

Blerim Grainca, propozoi që gjatë muajve në vijim, të kemi më shumë vizita në terren, tek prodhuesit vendorë, në ndërmarrjet publike dhe në agjencitë e pavarura, ta shohim punën e bordeve, që janë zgjedhur nga Kuvendi dhe që i raportojnë Komisionit Funkcional, se sa po i realizojnë detyrat dhe përgjegjësitë që kanë nëpër këto agjenci. Andaj, neve duhet të jemi më shumë në terren në muajt ardhshëm, për t'u njoftuar më për së afërmi me punën e tyre. Edhe pse Qeveria, në të shumtën e rasteve, propozon projektligjet, do të ishte mirë që Komisioni të marrë iniciativë për hartimin e ndonjë projektligji, aty ku ka zbrazëti, në pjesën e dytë.

Sala Berisha-Shala, tha se Komisioni për këta 5 muaj, ka bërë një punë shumë të mirë, përkundër vështirësive që ka pasur Kuvendi, ndërsa lidhur me vizitat në terren, pra nëpër agjenci, biznese dhe në kompanitë prodhuese, tha se duhet të planifikohen prej muajit qershor, që të realizohen këto vizita, në mënyre që të njoftohemi me problemet dhe vështirësitë që mund të kenë në aspektin ligjor dhe mundësinë që t'iu bëjmë zgjidhje. Në këtë kontekst, ajo potencoi se duhet të shohim edhe ndikimin e ligjeve të bizneset, sidomos Ligjin për minierat dhe mineralet, veçanërisht pjesa ku ka të bëjë me garancitë bankare, sepse kjo çështje po paraqitet si ngarkesë për bizneset.

Kryetari, tha se në kuadër të mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve, meqenëse u tha që Ligji për miniera dhe minerale po paraqet vështirësi për bizneset, propozoi që të fillohet me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për minierat dhe mineralet, ndërsa mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit për komunikimet elektronike, të shtyhet për sesionin vjeshtor, pasi që Ligji për minierat dhe mineralet ndërlihet edhe me çështjen e hartimit të Ligjit për Trepçën.

Besim Beqaj, tha se pajtohet plotësisht për monitorimin e zbatimit të Ligjit për miniera dhe minerale dhe propozoi që të themelohet grupi i punës për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit. Theksoi se Komisioni, gjatë këtyre muajve, ka zhvilluar shumë aktivitete, pra ka bërë punën e vet legjislative. Projektligjet që kanë ardhur nga Qeveria, na kanë marrë shumë kohë, qoftë në grupet e punës apo edhe në mbledhjet Komisionit. Projektligji për investimet strategjike, i cili është rregulluar substancialisht, por edhe pakon e projektligjeve për energjinë, ku është bërë një punë shumë e mirë, të cilat projektligje janë rregulluar deri në detaje. Ndërsa, sa i përket propozimit për nisma ligjore, tha se nëse kemi ide se duhet të rregullohet ndonjë fushë e rëndësishme, atëherë konsultohemi me Qeverinë dhe të kërkojmë prej Qeverisë që të rregullohet me ligj ajo fushë, nëse Qeveria nuk e ka në plan dhe nuk ka vullnet të hartojë projektligjin për ndonjë fushë të caktuar, e cila nuk është e mbuluar me legjislacion, atëherë mund të marrim nisma ligjore, ne si Komision.

Pas debatit, Komisioni nxori këtë:

Përfundim

- 1. Formohet grupi i punës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për minierat dhe mineralet, në këtë përbërje: Sala Berisha–Shala, kryesuese, Besim Beqaj dhe Blerim Grainca, anëtarë, si dhe t'i bashkohen edhe dy anëtarë të opozitës, ndërsa mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit për komunikime elektronike, të bartët në pjesën e dytë të vitit.*
- 2. Të formohen tri grupe për vizita në terren si vijon: grupi për vizita në agjenci të pavarura, që i raportojnë Komisionit; grupi për vizita në ndërmarrjet publike dhe grupi për vizita tek bizneset dhe prodhuesit.*
- 3. Të monitorohen rekomandimet për çështjet ndërsektoriale, të ngritura nga Komisioni në vitin e kaluar.*
- 4. Nxjerrja e rekomandimeve lidhur me Agjencinë e Statistikave të Kosovës, përkatësisht statistikave ekonomike, të bëhet në një nga mbledhjet e ardhshme.*
- 5. Idetë për nisma ligjore të propozohen dhe mandej të vazhdohet me procedim të mëtutjeshëm.*

8. Të ndryshme

Çështje vijuese

a) Çështja e kompanisë “Ferronikeli”

Kryetari, tha se deputetët Raif Qela dhe Sala Berisha-Shala, të bisedojnë me institucionet për problemet e ngritura nga kompania “Ferronikeli” dhe të shohim mundësinë se çfarë mund të bëhet, në kuadër të legjislacionit.

Fatmir Rexhepi, lidhur me kompaninë “Ferronikeli”, tha se për çështjen e blerjes së rrymës elektrike ka pasur kontratë me KEK-un dhe ka pasur privilegje për kyçje në linjë drejtpërdrejt, ndërsa si Komision, në këtë aspekt nuk kemi asnjë lloj përgjegjësie. Të shohim edhe gjendjen e kompanive të ngjashme në rajon, që të kuptohet a ka qenë menaxhimi apo çmimi që e kanë sjellë këtë situatë. Ai theksoi se muajve të fundit, industria e çelikut ka pasur rritje të çmimit. Duhet pasur parasysh edhe trendët, që janë në treg dhe çmimet varen prej zhvillimeve në bursa dhe Ferronikeli tani është kompani private, pra afarizmi i saj varet nga çmimi i tregut.

Besim Beqaj, tha se kjo është çështje komerciale e kompanisë dhe afarizmit të saj, që varet nga konkurrenca e çmimeve të tregut në bursa. Ne do të jemi pranë të gjitha bizneseve, në aspektin ligjor, por nuk duhet të hyjmë në çështje ekonomike të ndërmarrjes.

Kryetari theksoi se në takimin që e ka pasur me përfaqësuesit e kompanisë “Ferronikeli”, iu ka thënë se ata është dashur të krijojnë një fond rezervë për këto rrethana financiare.

b) Takimi me grupin e programit “Sfidat e mijëvjeçarit”

Kryetari njoftoi anëtarët e Komisionit se në ora 16:00, kanë një takim me një grup ekspertësh amerikanë nga programi “Sfidat e mijëvjeçarit” dhe i ftoi të marrin pjesë në takim.

Mbledhja përfundoi në orën 11:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Muhamet Mustafa